REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 595/23
Datë/Datum. 29.08.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Nr. 595/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Master Services" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE, DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE" me numër të prokurimit 634-23-6808-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal i Klinës në cilësinë e autoriteti kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën 29/08/2023, mori këtë:

VENDIM

1.Hedhet si e palejuar ankesa e Operatorit ekonomik "Master Services" SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 18/08/2023, numër protokolli 2023/0595, për aktivitetin e prokurimit "SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE , DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE", me numër të prokurimit 634-23-6808-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal i Klinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

2.I lejohet, autoritetit kontraktues –Kuvendi Komunal i Klinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE, DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE", me numër të prokurimit 634-23-6808-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të e-prokurimi me 18.08.2023, ka pranuar një ankesë nga OE "Master Services" SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me "SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE, DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE LOT 2-SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE", me numër të prokurimit 634-23-6808-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal i Klinës.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa edhe e dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave me datën 23.08.2023 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, ta plotësoj ankesën sipas nenit 111 të LPP në të kundërtën hedhet si e palejuar ankesa. Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së deri me datën 29.08.2023 OE ankues nuk ka kompletuar ankesën sipas kërkesës së institucionit.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "Master Services" SH.P.K.., e datës 18/08/2023 (protokoll 595/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull "SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE, DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE", me numër të prokurimit 634-23-6808-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Klinës konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe 111 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 65 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

OSHP i vë në dijeni OE ankues për mundësinë e zbatimit të nenin 118 paragrafi 4 cituar: Nëse paneli shqyrtues konstaton se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, OSHP mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguajë një gjobë shtesë deri në pesëmijë (5.000) Euro, duke ju referuar në rastin specifik nenit 111 paragrafi 10.

Autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal i Klinës, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK Kuvendi Komunal i Klinës
1x1 Master Services SH.P.K.
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.